



Suedi
Sverige



Unë

NUK JAM MË

një viktimë

Jam një e MBIJETUAR!



Unë zgjodha të jetoj në një mjedis pa dhunë, për veten dhe fëmijët e mi!

Je një grua e dhunuar?

Je në një marrëdhënie të dhunshme?

Nuk di ku të drejtohesh?

Ndihesh e paragjykuar?



Shoqata “Unë, Gruaja” ofron:

Mbështetje emocionale

Këshillim psikologjik falas:

1. Ne dëgjojmë shqetësimin tuaj
2. Nuk ju fajësojmë
3. Ruajmë konfidencialitetin
4. Ju mbështesim

Nëse keni plotësuar kërkesë-padi për UMM ose UM apo keni nisur procedurat e divorcit, raporti i vlerësimit psikologjik ofrohet falas nga shoqata, nëse viktimja e kërkon dhe Gjykata e vlerëson të drejtë.

Këshillim ligjor falas:

Pranë UG gratë e dhunuara mund të informohen lidhur me sistemin ligjor në Republikën e Shqipërisë, të drejtat dhe detyrimet që ato gëzojnë, aktet normative në fuqi, mënyrat e ushtrimit të të drejtave të individit, në proceset gjyqësore dhe ato jashtëgjyqësore.

Gjithashtu mund të drejtoheni pranë shoqatës “Unë, Gruaja”:

-Për të marrë këshillim juridik

-Për hartimin e dokumentave juridike

-Për t'u njohur me procedurat që duhet të ndjekë një grua e dhunuar, në zbatim të ligjit.

Shoqata bashkëpunon dhe bën referimet përkatëse për zgjidhjen e rasteve në institucionet e Mekanizmit të Referimit në Pogradec.



Një histori suksesi

*Em** kishte shenja në fytyrë dhe trup. U referua tek mjeku për të realizuar vizitë mjekësore dhe u pajis me raport mjeko-ligjor.

Shoqata UG i ka ofruar Emës ndihmë psikologjike dhe juridike falas. E ka ndihmuar duke e shoqëruar në Polici dhe Gjykatë për të marrë UMM dhe UM.

U referua në Zyrën e Barazisë Gjinore, Polici, Mjeku Ligjor, Njësinë Administrative përkatëse



për ndihmë ekonomike etj. *Em* shprehu se ndodhej pa mbështetjen e të afërmeve dhe e frikësuar për të qëndruar në banesën ku kishte jetuar më parë me ish-bashkëshortin. Ne e këshilluam që të shkojë tek Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Dhunës në Familje dhe e ndihmuam për të plotësuar dosjen.

Më pas rasti është ndjekur në seancat gjyqësore për zgjidhjen e martesës, është bërë raporti i vlerësimit për fëmijët nga shoqata UG, duke realizuar takime me klienten, fëmijët e saj dhe ish-bashkëshortin, i cili ndodhet në burg për dhunën e ushtruar. Në përfundim të gjyqit *Em* fitoi kujdestarinë e dy fëmijëve...

**Em* nuk është emri i vërtetë i klientes.

A e dini se:

Çdo grua e dhunuar që merr me vendim gjykatë Urdhër Mbrojtje (UM), si dhe secili fëmijë i përfshirë në këtë UM, u lind e drejta të përfitojnë nga 3000 lek në muaj për shkak të statusit si viktimë të dhunës në familje. Gruaja duhet të drejtohet për t'u informuar, pranë Njesisë Administrative apo Bashkisë.



Mund të jesh ti dritarja e shpresës!

Nëse keni një anëtare të familjes, mike, shoqe, kolege, të afërme, komshije, viktimë të dhunës në familje drejtojeni pranë shoqatës “Unë, Gruaja”, Pogradec.

Fletëpalosja u realizua nga Shoqata “Unë, Gruaja” në kuadër të projektit “Shërbime profesionale për viktimat e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje” me mbështetje nga Agjensia Ndërkombëtare për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida) dhe AWEN.

Sida dhe AWEN nuk janë domosdoshmërisht dakort me opinionin e shprehur. Shoqata “Unë, Gruaja” është përgjegjëse për përmbajtjen.

Shoqata ofron falas mbështetje emocionale, psikologjike dhe juridike për gratë e dhunuara, informacion rreth dhunës në familje, ligjeve dhe institucioneve që ju mbështesin.

Shoqata “Unë, Gruaja”, Pogradec

083222140

Nga e hëna deri të premte

Ora 9.00 -17.00

Në qoftë se jeni në rrezik
ose keni nevojë urgjente për ndihmë

Telefononi:

Policia

129 ose **112** (24 orë falas)

Urgjenca e spitalit

127 (24 orë falas)



Linja Kombëtare e Këshillimit

116117 (24 orë falas)

Na ndiqni:

 Shoqata Une, Gruaja

www.unegruaja.org

Denonconi dhunën:

Dërgoni mesazhe, foto, video: **0676470005**



Shkarkoni aplikacionin:

Une, Gruaja



në Play Store

